



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Fjalimi përshëndetës i Guvernatorit

Nëntor 8, 2023

Konferenca: Krijimi i vlerave - porta e së ardhmes

Organizator: Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Koha dhe vendi: 8 nëntor 2023 ora 10:00, Swiss Diamond Hotel, Prishtinë

E nderuara, znj. Mehmeti - Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës,

I nderuar, z. Pllana, Kryetar i Bordit të SHKÇAK-ut,

I nderuari, z. Murtezaj, Drejtor Ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës,

I nderuar, z. Xhema, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Njësisë të Inteligjencës Financiare,

I nderuar, z. Perani, përfaqësues i Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC),

Të nderuar përfaqësues të institucioneve financiare,

Të nderuar përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe atyre profesionale,

Të nderuar panelistë,

Të respektuar pjesëmarrës,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që fillimisht të falënderoj Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK) për ftesën që të ju drejtohem me kënaqësi me këtë fjalë hyrëse me rastin e shënimit të Javës së profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit, duke nënvizuar rëndësinë që kanë këto profesione për të pasqyruar drejt gjendjen dhe performancën e entiteteve biznesore, respektivisht për të siguruar vlerësime të pavarura dhe objektive mbi saktësinë dhe qëndrueshmërinë e informacioneve financiare.

Duke marrë parasysh rëndësinë që luajnë entitetet biznesore në zhvillimin ekonomik të vendit, pasqyrimi i drejtë i gjendjes dhe performancës së aktivitetit të tyre është i një rëndësie të veçantë për të ndërtuar një ekonomi të qëndrueshme, si dhe një shtet të zhvilluar dhe me

integritet. Nisma si zhvillimi i tregjeve të kapitalit dhe të tjera, kanë parakusht një element të tillë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës sipas mandatit të saj për të licencuar, rregulluar dhe mbikëqyrur institucionet financiare në Republikën e Kosovës në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar është angazhuar që të ofrojë kornizë rregullative në harmoni me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për qëllim të raportimit dhe auditimit të institucioneve financiare, si dhe miratimit të auditorëve të jashtëm që auditojnë këto institucione.

Pra, në rolin mbikëqyrës që ka BQK-ja, profesioni i auditorit të jashtëm shërben si një mjet i rëndësishëm në arritjen e qëllimit të saj.

BQK-ja bashkëpunon ngushtë me Këshillin Kosovar për Raportim Financiar për të promovuar ngritjen e cilësisë së funksioneve mbikëqyrëse dhe të raportimit financiar, ku sipas ligjit, BQK-ja ka edhe përfaqësuesin e saj në këtë Këshill dhe Bordin për Mbikëqyrje Publike.

Gjithashtu, BQK është e angazhuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e kontabilitetit dhe auditimit përmes trajnimeve dhe certifikimeve në institucionet e specializuara në këtë fushë. Kualifikimi dhe edukimi i vazhdueshëm profesional, përbën edhe orientim për BQK-në, si për stafin e saj, ashtu edhe për gjithë industrinë financiare.

Theks i veçantë në rregullativen e BQK-së do t'i kushtohet edhe përfshirjes në rregullativ të rolit të kontabilitetit të certifikuar si dhe auditorit të brendshëm të certifikuar, krahas kërkesave për auditim të jashtëm.

BQK është në proces të harmonizimit të legjislacionit sa i përket standardeve për angazhimin e auditorëve të jashtëm, si në kuptimin e afatit sa vite mund të angazhohet, ashtu edhe kufizimin e shkëputjes nga auditimet e njëpasnjëshme.

BQK-ja po ashtu angazhohet që përmes rregullatives dhe mbikëqyrjes së institucioneve financiare për parandalimin e pastrimit të parave, si dhe bashkëpunimit të ngushtë me autoritetet tjera në nivel të vendit, të ndikojë në zvogëlimin e ekonomisë informale dhe ngritjes së një ekonomie të qëndrueshme dhe zhvillimore afatgjate.

Sfida si zbatim i standardeve të reja për industrinë financiare, me fokus në atë të sigurimeve, siç është SNRF 17, shpërfaq nevojën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve rregullatore, politikëbërëse, sektorit financiar, akademisë dhe organizatave profesionale.

Gjithashtu, në kuadër të përkushtimit për të përmirësuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin, do të angazhohemi në harmonizimin e kornizës rregullative me rregulloret dhe direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardeve të Bazelit, duke fuqizuar praktikat mbikëqyrëse.

Aplikimi i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar S1 dhe S2 mbi shpalosjen e informacioneve të entiteteve biznesore për menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe të ambientit, si dhe mundësi të investimit në funksion të ekonomisë së gjelbër, gjithashtu do të ketë fokusin e BQK-së.

Në fund, në si BQK presim që të kemi pasqyra financiare sa më të sakta dhe auditime më cilësore, në funksion të paraqitjes së drejtë të gjendjes reale të pasqyrave financiare të entiteteve biznesore, për të lehtësuar vendimmarrjen e drejtë, kreditimin nga bankat, ofrimin e

produkteve të sigurimit dhe shërbimeve tjera financiare nga institucionet financiare me qëllim të zhvillimit të sektorit privat dhe ekonomisë së Republikës së Kosovës në përgjithësi.

Rritja e kapaciteteve profesionale dhe sigurimi i cilësisë mbeten prioritetet tona, që ndihmojnë në arritjen e objektivave të BQK-së, por edhe zhvillimit të gjithmbarshëm të vendit.

Ju uroj diskutime të frytshme dhe të suksesshme në panelet në vijim.

Ju faleminderit!